



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPLJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRILJENO DANA: 24.07.2026			
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
1	400103	34113	



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

24.07.2026

Zyra e kryetarit të komunës

PROCESVERBALET E ORGANIZIMEVE TË DËGJIMEVE BUXHETORE PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2027–2029



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029

Data: 25.06.2026

Ora: 13:30

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Takimi i Parë: Përfaqësuesit e Kuvendit Komunal dhe Komitetet

Numri i pjesëmarrësve: 13

Burra: 9

Gra: 4

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjatë këtij takimi, Drejtori për Buxhet dhe Financa bëri një prezantim të shkurtër të buxhetit të Komunës së Lipjanit, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen në takimin e parë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, me theks të veçantë në investimet kapitale dhe investimet e tjera që do t'i realizojë Komuna gjatë viteve 2027–2029.

Diskutimet:

Rinor Murati

Kërkoj që ndërtimi i rrugicave të zëvendësohet me ndërtimin e dy urave në Ruboc të Madh.

Shahdije Bikliqi Dragaqina

Kërkoj që të keni prioritet Ujësjellësi dhe kanalizimi në fshatrat në përgjithësi.

Hyra Bytyqi

Të ndahet më shumë buxhet për projektet që fuqizojnë gratë në biznes, si dhe për të rinjtë dhe të rejat në fushën e teknologjisë, pasi kjo është një fushë me rëndësi të veçantë për zhvillimin e biznesit. Gjithashtu, kërkohet rikonstruimin e rrugës nga fshati Medvec deri në Magurë.

Latif Ramadani, Drejtor për Buxhete dhe Financa



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

Theksoi se çdo kërkesë do të shqyrtohet dhe se buxheti do të planifikohet në mënyrë sa më të balancuar. Nënvizoi se janë duke u mbledhur propozimet për vitet 2027–2029, ndërsa projektet për vitin aktual janë në proces të implementimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029

Data: 25.06.2026

Ora: 14:30

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Takimi i Dytë: Gratë dhe shoqatat e grave

Numri i pjesëmarrësve: 29

Burra: 7

Gra: 22

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjatë këtij takimi, Drejtori për Buxhet dhe Financa bëri një prezantim të shkurtër të buxhetit të Komunës së Lipjanit, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen në takimin e parë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, me theks të veçantë në investimet kapitale dhe investimet e tjera që do t'i realizojë Komuna gjatë viteve 2027–2029.

Diskutimet:

Bekim Krasniqi

Kërkoj që të planifikohet shtimi i çerdheve për vitet 2027–2029, me qëllim të lehtësimit të punësimit të grave.

Saranda Krasniqi

A është planifikuar ndërtimi i ndonjë çerdheje në qytetin e Lipjanit?

A do të ketë trajnime apo do të ketë vetëm mbështetje financiare për fillimin e një biznesi?

Ganimete Gashi

A do të ketë përkrahje për startup-et, pasi që unë merrem kryesisht me gatimin e produkteve tradicionale?



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Latif Ramadani, Drejtori për Buxhete dhe Financa

Ka potencuar se në Komunën e Lipjanit është planifikuar ndërtimi i një çerdheje. Siguroi se të gjitha kërkesat që vijnë nga drejtoritë përkatëse do të shqyrtohen gjatë hartimit të KAB-it dhe se jemi ende në fazën fillestare të këtij procesi.

Sa u përket startup-eve, Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe ministritë përkatëse, vazhdimisht ka mbështetur bizneset e reja.



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029

Data: 25.06.2026

Ora: 16:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Takimi i tretë: Organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit

Numri i pjesëmarrësve: 21

Burra: 17

Gra: 4

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjatë këtij takimi, Drejtori për Buxhet dhe Financa bëri një prezantim të shkurtër të buxhetit të Komunës së Lipjanit, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen në takimin e parë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, me theks të veçantë në investimet kapitale dhe investimet e tjera që do t'i realizojë Komuna gjatë viteve 2027–2029.

Diskutimet:

Arian Zeneli

Çfarë po ndodh me subvencionet për klubet sportive dhe ku ka arritur procedura?

Enis Jashanica

Si subvencionohen shkollat e futbollit dhe cilat janë kriteret?

A duhet të merret parasysh niveli i shpenzimeve apo numri i futbollistëve?

Bekim Krasniqi

Kërkoj që subvencionet të ndahen veçmas për sportin dhe veçmas për rininë.



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Të ndahen mjete për mirëmbajtjen e terreneve sportive nëpër fshatra.

Latif Ramadani, Drejtori për Buxhete dhe Financa

Sigurisht të gjitha kërkesat do të trajtohen së bashku me drejtoritë përkatëse dhe, për secilën kërkesë, do të vlerësohen mundësitë buxhetore. Mjetet do të ndahen në mënyrë proporcionale. Komuna e Lipjanit vazhdimisht ka rritur buxhetin, përfshirë edhe buxhetin për subvencione, si për sportin, ashtu edhe për rininë, dhe besoj se do të vazhdohet me përkrahjen.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029

Data: 25.06.2026

Ora: 17:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Takimi i katërt: Qytetarët e Lipjanit dhe këshillat e fshatrave

Numri i pjesëmarrësve: 6

Burra: 5

Gra: 1

Në kuadër të procesit të dëgjimeve publike për Kornizën Afatmesme të Buxhetit të Komunës së Lipjanit, është mbajtur takimi i radhës me qytetarët e Lipjanit.

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjatë këtij takimi, Drejtori për Buxhet dhe Financa bëri një prezantim të shkurtër të buxhetit të Komunës së Lipjanit, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen në takimin e parë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, me theks të veçantë në investimet kapitale dhe investimet e tjera që do t'i realizojë Komuna gjatë viteve 2027–2029.

Diskutimet:

Agron Zeqiri

Kërkoj asfaltimin e rrugicave në Hallaq të Madh. Po ashtu, problem kemi edhe me qentë endacakë.

Latif Ramadani, Drejtori për Buxhete dhe Financa

Edhe këtë vit, Komuna ka paraparë asfaltimin e rrugicave nëpër fshatra. Ndërsa, sa i përket problemit me qentë endacakë, Komuna aktualisht është duke e trajtuar këtë çështje përmes një kontrate për trajtimin e qenve endacakë dhe, varësisht nga kërkesat, kompania është duke u marrë me raste të tilla.



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029

Data: 25.06.2026

Ora: 18:00

Vendi: Shkolla Fillore në Grackë të Vjetër

Takimi i gjashtë: Qytetarët e Grackës së Vjetër

Numri i pjesëmarrësve: 3

Burra: 2

Gra: 1

Prezantimi i Buxhetit:

Gjatë këtij takimi është bërë prezantimi, në pika të shkurtra, i buxhetit të Komunës së Lipjanit, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen në takimin e parë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, me theks të veçantë në investimet kapitale dhe investimet e tjera që do t'i realizojë Komuna gjatë viteve 2027–2029.

Diskutimet:

Zoran Cirkovic,

Si kërkesë është asfaltimin i një rrugice në fshatin Grackë,

Kërkesa tjetër është mirëmbajtja e ndriçimit publik pasi që disa drita janë prish dhe kërkojmë që të riparohen ose të ndërrohen.